



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:048616

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05748989

KF.nr.351/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Company 21” SH.P.K., me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sh.B. dhe V.V. kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, në rigjykim-rivendosje sipas Aktvendimit K.Dh.Sh.II.nr.1086A/22 të datës 02.06.2023, të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësueseve të autorizuar të palës paditëse Sh.B. dhe V.V., e në mungesë të palës së paditur, me datë 14.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Company 21” SH.P.K., me seli në Prishtinë, dhe OBLIGOHET e paditura ATK-ka ta liroj këtu paditësin “Company 21” SH.P.K., me seli në Prishtinë nga ngarkesa me tatim në të ardhura nga qiraja, për objektet kontestuese për periudhën tatimore 2017-2018, si dhe t’ia njoh si shpenzim kamatën për kredinë me destinim për të blerë shtëpitë e banimit në lagjen Marigona në vlerë prej 280,000.00 Euro për periudhën tatimore 2017-2018.
- II. ANULOHET pjesërisht Vendimi nr.577/2020 i datës 12.03.2020 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe atë vetëm sa i përket ngarkesës me tatim në të ardhura nga qiraja për objektet kontestuese për periudhën tatimore 2017-2018, si dhe t’ia njoh si shpenzim kamatën për kredinë me destinim për të blerë shtëpitë e banimit në lagjen Marigona në vlerë prej 280,000.00 Euro, për periudhën tatimore 2017-2018.
- III. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit “Company 21” SH.P.K., me seli në Prishtinë, dhe atë lidhur me mos njohjen e shpenzimeve të interesit

për kredinë për investime në Maqedoninë e Veriut, dhe mos njohjen e zhvlerësimit respektivisht të investimeve në sallën 1 Tetori – Prishtinë për periudhën kontestuese 2017-2018.

IV. MBETET NË FUQI Vendimi nr. 577/2020 i datës 12.03.2020 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, lidhur me mos njohjen e shpenzimeve të interesit për kredinë për investime në Maqedoninë e Veriut, dhe mos njohjen e zhvlerësimit respektivisht të investimeve në sallën 1 Tetori – Prishtinë, për periudhën kontestuese 2017-2018.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate me Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr.1086A/22 të datës 02.06.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit “Company 21” SH.P.K., me seli në Prishtinë, e ka prishë Aktgjykimin A.nr.775/20 të datës 08.12.2021 dhe lëndën e ka kthyer kësaj gjykate në rigjykim dhe rivendosje.

Me vendimin kontestues e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë (ATK) ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit dhe ka ndryshuar Njoftim Rivlerësimit e tatimit shtesë për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave CD për periudhat 2017-2018 dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për periudhat 01/2017-12/2018.

Paditësi “Company 21” SH.P.K., me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK-së, me të cilën ka kërkuar të pranohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, të anulohet në tërësi vendimi i ATK-së nr.577/2020 i datës 12.03.2020 dhe të lirohet paditësi nga obligimet tatimore shtesë të caktuara me kontroll. Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar, në seancën publike, paditësi deklaroi se: Mbesim pranë padisë sonë të datës 14.04.2020, që është paraqitur kundër vendimit të ATK-ës, gjegjësisht vendimit nr. 577/2020 të datës 12.03.2020, e cila është paraqitur pranë gjykatës kompetente. Ekspertizën financiare e kemi pranuar ndaj të njëjtës kemi vërejte dhe nuk pajtohemi në vlerësimet dhe konstatimet sikurse në ekspertizë. Mos pajtimi në raport me ekspertizën financiare është në pikëpamje të selektimit ligjor si dhe gabimet profesionale materiale. Për të tri pikat tona pretenduese sipas padisë të cilat janë elaboruara me ekspertizë ne i kundërshtojmë si në vijim: Sa i përket pikës së parë referuar qirasë që ka të bëjë me villen në

Brezovicë dhe shtëpitë në lagjen Marigona, kundërshtimi ynë si për aktin e vendimit të ATK-ës si për ekspertizën financiare vazhdon të jetë i bazuar në aspekte ligjore dhe ngjarje reale që kanë ndodhur. Nga vetë fakti që edhe zyrtarët tatimor por që këtë rast kanë gjetur mbështetje edhe me ekspertizë financiare duke tentuar të i ndryshoj faktet për të gjetur argument për një ngjarje që nuk ka ndodhur e sjellë këtë huti dhe nuk ka as bazë ligjore të deklarimit as nga ATK –ja dhe as nga ekspertiza. E argumentojmë nuk ka asnjë fakt as ATK –ja dhe as eksperti financiar se dëshmon që “TV 21” ka krijuar të ardhura nga qiraja, kjo mund të vërtetohet nga pasqyrat bankare, pasqyrat e kontabilitetit dhe nga cili do fakt i palës së tretë, që janë të gjitha elemente që do të ishin ligjore për të argumentuar një të hyrë. Nga vetë fakti se një herë argumenti i ATK-ës ishte shitje e këtyre shtëpive, ndërsa me një raport shtesë sipas ATK-ës nderohet nga shitja në qira. Edhe sikur të kishte argumente se ka të ardhura nga qiraja për këtu paditësin ATK-ja nuk guxon të bëjë selektim ligjor të cilët të njëjtën gjë e ka bërë edhe eksperti financiar, sepse ligji për të ardhura e korporatave 05/L-029 , neni 5 i ligjit, pika 3.1 dhe 4.1, citoje: “Në momentin kur një pasuri ose një aset i kompanisë futet në përdorim nga ajo datë fillonte e drejta e zhvlerësimit të kësaj pasurie ose të këtij aseti, në rastin konkret ATK-ja përfshirë dhe ekspertizën theksojnë se ndërtesat janë futur në funksion në vitin 2018 dhe për çudi thirrën në nenin për të ardhurat nga qiraja, e anashkalojnë nenin për shpenzimet e zhvlerësimit të lartë cekur, me këtë arsye sepse të ardhurat nga qiraja sipas ATK-ës janë rreth 20,000.00€, ndërsa shpenzimet e zhvlerësimit vetëm për një vit për këto ndërtesa bazuar në vlerën tyre kushtuese që janë 1.5 milion € X 5 % që e lejon ligji për korporata i bie që të jenë 75,000.00 € shpenzime vjetore, mbi shumën e të ardhurave që do të kishte krijuar humbje dhe jo fitim siç pretendohet nga e paditura. Ne e kuptojmë pse ATK nuk e ka bërë këtë, ose ka menduar se nuk e trajtojmë se po të ishte trajtuar do i bie që këtu paditësin ta fuste në kreditim. Gjë për te cilën ne nuk e kemi bërë, për arsyen e plotë, ne akoma nuk e kemi pasur asetin në pasqyrat tona i kemi pasur investimet në vijim që nuk janë futur në funksion dhe që po ashtu akoma nuk kanë qenë pronë e “RTV21” legalisht, dhe atë deri në vitin 2021 vit ky në të cilën ka kaluar pronësia te RTV 21. Tek pika e dytë lidhur me interesin e shpenzimeve të kredisë , argëtojmë edhe një herë bazën tonë ligjore dhe kundërshtojmë aspektin jo ligjor të ATK –ës dhe të ekspertizës financiare. Ligji për tatime në të ardhura e korporatave, neni shpenzimet e pa pranuar në asnjë moment nuk përmend që shpenzimet e interesit janë të pa pranuar. Ndërsa neni 9 lidhur me shpenzimet për aktivitet ekonomik të biznesit citon se “ Shpenzimet që lidhen me aktivitetin ekonomik janë shpenzime të pranuar ” pra ky është argumenti jonë ligjor. Sqarojmë tutje kredia është marrë në emër të biznesit dhe nuk ka gjasë që një banke të i jep biznesit kredi për shpenzime jashtë biznesit, fakt tjetër është se duhet të saktësohet edhe destinacioni i kredisë i cili ka qenë për asetet e kompanisë

brenda Kosovës që ishte për shtëpitë në lagjen “Marigona”, dhe hapja e “TV 21” në Maqedoninë e Veriut, ku kompania 21 me seli në Prishtinë dhe jo në Lipjan siç thotë eksperti në raportin e vet është në pronësi 100 % të saj dhe jo siç thotë eksperti nuk e kemi të qartë pronësinë. Vetë raporti i ATK –ës nuk ka vu argument për me kundërshtim investimin e këtu paditësit në Maqedoninë e Veriut, por në atë kohë si argument i vetëm i ATK –ës , se investimet janë bërë jashtë vendit dhe si të tilla janë të pa pranuar për ATK. Më vonë vetë e paditura e ndërron argumentin dhe tani thirret se nuk janë verifikuar shpenzimet dhe pronësia në Maqedoninë e Veriut. Si rrjedhojë në lëndën e gjykatës kemi shtuar shkresa shtesë ku janë ofruar dëshmia e pasqyrave financiare të konsoliduar, statuti i kompanisë në Maqedoninë e Veriut, dhe disa DUD-a që tregojnë se janë ekspertuar asetete nga Prishtina në Shkup. Ekspertiza financiare thotë se nuk ka arrit në pasqyrat e konsoliduara të lëshuara nga auditori i kompanisë, të saktësojë pronësinë në Maqedoninë e Veriut. Kjo na bie dy informatat, e para eksperti nuk i ka shfletuar të gjitha shkresat nga lënda e gjykatës, sepse do të thotë se nuk i ka shikuar pasqyrat financiare të konsoliduar dhe e dyta nuk e ka parë statutin fare. Në një citim thotë ekspertiza se “ *nuk ka qartësi në pasqyrat e konsoliduara për emrin e kompanisë në Maqedoninë e Veriut*” dhe siç do të kishte bashkëpunuar me neve siç do të ishte e arsyeshme ne do të ia sqaronim edhe ato gjëra që mund të mos jenë kuptuar. Pika e tretë që ka të bëjë me shpenzimet e zhvlerësimit për investimet e bëra në sallën “ 1 Tetori” edhe te kjo pikë si ATK ashtu dhe eksperti financiar bëjnë selektim të interpretimeve ligjore. Argumentoje, ligji për tatimin në të ardhurave të korporatave përmes shpenzimit e zhvlerësimit në investimit në asetet e marra me qira do të njihet si të plota me përpushmëri me kohën e shfrytëzimit. Dhe tani cila është periudha e përdorimit, sipas kontratës që është bërë nga këtu paditësi dhe sallës 1 tetori, kjo periudhë ka qenë 2013-2017. Investimet në tërësi kanë ndodhur në vitin 2013, që janë rreth 25.000.00 €. Sipas ligjit kjo shumë duhet të përpjesëtohet me vitet që do të përdoret. Rrethanat e pa vullnetshme të kompanisë në 2014, bordi i këtu paditësit në bashkëpunime sallën 1 tetori kanë marrë vendim për shkëputjen e kontratës. Tani shpenzimet e zhvlerësimit TV21 ose është dashtë të kthehet të bëjë korrigjim në deklaratimet e vitit 2013 ose të vazhdohet deri sa te bëhet mbyllja edhe në vitet vijuese. Parimisht shpenzimi i zhvlerësimit patjetër është 25.000.00 , kjo vetëm ka ndryshuar në kohë dhe argumente të tjera të ATK-ës se nuk ka më përdorim të sallës nuk qëndrojnë ose ishte dashtë vetë ATK-ja ta bëjë korrigjimin e 2013, duke i njohur shpenzimet në tërësi dhe mos ti lërë nëpër vitet e ardhshme ashtu që efekti tatimor do të ishte i njëjtë. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura në përgjigjen në padi i kundërshton pretendimet e paditësit si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi kontestues është i drejtë dhe në harmoni të plotë me

legjislationin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Nuk qëndron pretendimi për shkelje thelbësore të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sepse paditësi pos konstatimeve të përgjithësuara nuk ka ofruar asnjë argument për shkelje konkrete thelbësore të dispozitave në fjalë, që do të kishin ndikim në marrjen e ndonjë veprimi ndryshe nga ajo që është vendos në dispozitiv dhe është arsyetuar në vendimin e kontestuar. Nuk qëndron pretendimi i paditësit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike lidhur me kontestin për ngarkesë tatimore mbi bazën e të ardhurave nga qiraja për dy vikend shtëpizat në Brezovicë dhe katër shtëpive në lagjen Marigona, sepse disponuar më të dhënat nga palët e treta se paditësi ka realizuar të hyra nga klientët në formë të qirasë në emër të shfrytëzimit të këtyre objekteve, për shkak të dedikimit dhe shfrytëzimit të këtyre objekteve për qëllime jo biznesore, atëherë kontrolli i ka trajtuar pa të drejtë si shitje në konsideratë, ku pas sigurimit të informatave shtesë sipas Raport kontrollit sqarues të datës 10.03.2020, është vërtetuar se këto objekte në bazë të çertifikatës mbi pronësinë dhe kopjes së planit janë pronë e paditësit, atëherë me vendimin kontestues paditësi është liruar nga qarkullimi shtesë dhe tatimi shtesë në bazë të shitjes në konsideratë, dhe ngarkohet vetëm me obligime tatimore nga të hyrat prej qirasë për periudhën kontrolluese 2017-2018. Si rezultat i këtyre ndryshimeve paditësi lirohet nga ngarkesa e tatimit bazë në shumë prej 93,216.36€. Bazuar në informatat e palëve të treta për kohën e vendqëndrimit të klientëve, çmimi prej 100.00€ për një natë për shfrytëzimin e vikend shtëpizave dhe faturat e energjisë elektrike mbi transaksionin e konsumatorit nga distribucioni rezulton se paditësi për vitin 2017 ka realizuar të hyra nga qiraja mujore në vlerë të tatueshme prej 5,393.22€, ndërsa për vitin 2018 për dy vikend shtëpizat në Brezovicë dhe katër shtëpi në lagjen Marigona ka realizuar të hyra nga qiraje në vlerë të tatueshme 10,677.97€. Është i pabazë pretendimi i paditësit për njohjen e shpenzimeve të zhvlerësimit si shpenzim i zbritshëm për TAK 2017 në vlerë prej 6,139.60€ për investimet në qendrën e studentëve në Prishtinë, me qëllim të shfrytëzimit për nevoja të klubit të basketbollit sepse me vendimin e Bordit nr.07/2014 të datës 30.01.2014, Klubi ka ndërprerë aktivitetin e tij në vitin 2017 dhe nuk ka përdorim të hapësirës sipas dedikimit për investimet e kryera në bazë të Kontratës në mes të paditësit dhe Qendrës së Studentëve të lidhur me datë 14.03.2013. Nuk është i bazuar pretendimi i paditësit për njohjen si shpenzim i zbritshëm të shpenzimeve të interesit në vlerë prej 184,828.21€ në emër të kredisë të shfrytëzuar për hapjen e televizionit në Republikën e Maqedonisë së veriut, mjete nga pjesa e kredisë prej 2,000.000.00€ e akorduar nga NLB-ja, të angazhuara për blerjen e pajisjeve të nevojshme, renovimit të objektit, shpenzime operative, sepse paditësi nuk ka ofruar dëshmi mbi statusin e regjistrimit të RTV-së në Maqedoni të Veriut, dhe se në pasqyrat e veta financiare nuk ka deklaruar të hyra që ka realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut si të

hyra nga burimi i jashtëm në vështrim të nenit 2 paragrafi 1.8 i Ligjit 05/L-029, prandaj të njëjtat nuk mund të njihen e të pranohen si shpenzim i zbritshëm. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë e paditësit dhe që ta vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj Vendimin e D.A. të ATK-së nr.577/2019 të datës 12.03.2020. Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se pala e paditur përmes parashtresës së datës 03.05.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në seancë dhe ka kërkuar që të veprohet në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 14.05.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimi nr.2165/2019 i datës 18.11.2019, njoftim vlerësimet, raporti i kontrollit i datës 05.11.2019, kundërshtimi i ushtruar në ATK i datës 18.12.2019, konfirmimi mbi kalimin e pronësinë i datës 26.09.2019, korrespondenca – email të datës 07.10.2019, 01.07.2019, 18.11.2019, 05.11.2019, 04.11.2019, 07.11.2023, 06.11.2023, 25.10.2023, njoftimi nga ATK i datës 14.02.2020, vendimi nr.577/2020 , i datës 12.03.2020, konkluzionet nga mbledhja e bordit të datës 25-28 shkurt 2019, 19-23 shkurt 2018, 6-7 prill 2017, 3-4 qershor 2016, certifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme nr. UL-72717094, së bashku me kopjet e planit, kontrata e shitblerjes nr. 2/2020 e datës 15.03.2010, dhënia e pëlqimit për bartje të pronësisë e datës 18.11.2019, përgjigja në padi e datës 26.04.2021, transaksionet E-Kesco, kërkesa për informatat nga palët e treta, pasqyra e tatim paguesit së bashku me gjendjen e borxheve e datës 26.04.2021, 02.12.2021, pasqyrat financiare të konsoliduar dhe raporti i auditorit të pa varur i datës 31.12.2018, bilanci i gjendjes- pasqyra e të ardhurave, pasqyrat për fitim tjetër gjithë përfshirës, pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet e datës 01.07.2019, vendimi 557/2019, i datës 12.02.2020, certifikata e biznesit nga regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, kontrata nr. 2691/2021 e datës 13.07.2021, deklarata mbi themelimi e shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga një person e datës 07.05.2015, raport kontrolli sqarues i datës 09.03.2020, proces verbali i ATK –ës i datës 29.01.2020, ekspertiza financiare e datës 25.03.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në

përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, gjykata konstaton se e paditura ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit dhe ka ndryshuar Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave CD për periudhat 2017-2018 dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për periudhat 01/2017- 12/2018. E paditura duke u bazuar në Raportin Plotësues dt.11.03.2020 ka liruar paditësin nga qarkullimi shtesë për shtëpitë kontestuese në lagjen Marigona dhe në Brezovicë, por është ngarkuar me të hyra nga qiraja sipas vlerës së hapur të tregut për periudhën 2017-2018 dhe TAK 2017-2018. Ndërsa pretendimet tjera ankimore të palës paditëse janë refuzuar.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.351/23 të datës 29.11.2023, ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar R.S., me detyra përkatëse sikurse në këtë aktvendim.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra të ekspertit financiar në ekspertizën financiare të datës 12.06.2023 si dhe sqarimeve të paraqitura edhe në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 14.05.2024, nga ana e ekspertit financiar R.S., i cili thekson se: *ekspertiza financiare është përpiluar kryesisht nga detyrat e dhëna nga gjykata dhe pyetjet e parashtruara në aktvendim. Në këtë seance vlen të theksohet se ne kemi pasur takime me palën paditëse , gjithashtu kemi konsultuar gjithë dokumentacioni ekzistues në shkresat e lëndës, mandej duke përfshirë edhe raportin e pasqyrave financiare të konsdiliduara , statutin e kompanisë 21 në Maqedoninë e Veriut dhe dokumente e tjera relevante në lëndë. E rëndësishme për tu theksuar është se padia e ngritur është bazuar ne vendimin e DA-se të ATKA –së , duke mos e përfshirë edhe një raport plotësues të cilin ATK e kishte bërë në proces të ankesës, për të cilën edhe pala paditës e ka pohuar një gjë të tillë dhe të cilin raport nga shkresat e lëndës iu ka dorëzuar në rastin e takimit konsultativ me paditësin , kjo ngase rezultate me raportin fillestar të kontrollit të datës 13.11.2019, kanë qenë tatim shtese për të ardhurat e korporatës për vitin 2017, në vlerë prej 9.953.13 €, dhe për vitin 2018 vlera prej 121.453.10 €, derisa me raportin sqarues të dytë të ATK A-ES , ATK kishte anuluar pjesën e tatimit shtesë për vitin 2019, në vlerë prej 110.814.55 €, duke shtuar obligimet për llojin e tatimit të vlerës së shtuar në emër të qirave , në shumë prej*

16.271.66 €, si qeshte theksuar në faqen 6 të kësaj ekspertizë. Sa i përket vërejtjeve të palës paditëse në këtë seancë lidhur me refuzimin e rezultatit të ekspertizës, mandej edhe atyre që janë në favor të tyre theksojmë se nga vendimi kontestues i ATK-ës, me ekspertizë është korigjuar pjesa e qirave për shtëpitë në Brezovicë, si e pa bazuar me fakte relevante ndryshe nga ajo sikurse në raport kontrolli, derisa ka mbetur si vlerësim i drejtë pjesa e qirave për shtëpitë e banimit në Marigonë, për pjesën- periudhën, derisa ato ishin të banueshme gjatë periudhës së kontrollit. Gjithashtu për pikën 3, në ekspertizë lidhur me shpenzimet e interesit të kredisë, me këtë ekspertizë janë pranuar apo janë pranuar si shpenzime e gjithë pjesa e interesit e investuar në Kosovë për pjesën e investimeve në TV dhe në shtëpitë në Marigonë. Përderisa nuk kemi mundur të atribuojmë shpenzimet e interesit për kompaninë në Maqedoni të Veriut, në mungesë të pasqyrave financiare të kësaj kompanie, shpалosjen e shpenzimeve e të interesit dhe investimeve në këtë kompani si dhe transaksionet bankare të këtyre mjeteve në Maqedoni e Veriut. Për më shumë janë të elaburuara në ekspertizë në detaje.

Lidhur me ekspertizë është deklaruar edhe e paditura përmes parashtresës së datës 03.05.2024.

Gjykata e ka pranuar pjesërisht ekspertizën financiare të ekspertit R.S., si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë në raport me detyrat referuar shpenzimeve të interesit për kredinë për investime në Maqedoninë e Veriut dhe për shtëpitë në lagjen Marigona, dhe mos njohjen e zhvlerësimit respektivisht të investimeve në sallën 1 Tetori – Prishtinë për periudhën kontestuese 2017-2018, por jo edhe sa i përket ngarkesës me tatim në të ardhura nga qiraja për objektet kontestuese për periudhën tatimore 2017-2018.

Vlerësimet faktike dhe juridike lidhur me pikën I dhe II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Gjykata edhe përmes nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare ka konstatuar se ATK-e, me raport Kontrolli dhe me Vendimin e Departamentit të ankesave nuk ka pas prova të mjaftueshme kur ka vendos Tatimin mbi qira për 2 vikende shtëpizat në Brezovicë sepse për të njëjtat nuk ka ofruar të dhëna konkrete apo prova se të njëjtat janë dhënë me qira apo janë përdorë për nevoja banimi nga pronaret/aksionaret dhe me një vlerësim të hamendësuar kanë vlerësuar si konsiderate (dhënie me qira) këto dy objekte në Brezovicë. Po ashtu gjykata nuk pajtohet edhe lidhur me vlerësimin e ATK-së referuar 4 shtëpive në lagjen Marigona, dhe vetëm mbi bazën e asaj se të njëjtat kanë qenë të banueshme dhe në bazë të informatave nga palët e treta referuar faturave të energjisë elektrike duke e vu në konsideratë dhe kalkuluar tatimin shtesë për TVSH

dhe Tatimin në Qira WR, për këtu paditësin për periudhën e vitit 2018, pa gjetur të dhëna konkrete mbi qiramarrësit eventual, dhe pa i bazuar kota konstatime në kontrata përkatëse eventuale të shfrytëzimit të këtyre objekteve me qira, nga palët e treta.

Andaj, Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar në pjesën që i referohet ngarkesës me tatim në të ardhura nga qiraja nga objektet-villat në Brezovicë dhe shtëpitë në lagjen Marigona, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për vendosje ndryshe nga ajo sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Tutje Gjykata lidhur me kredinë investuese ka gjetur se këtu paditësi kishte tërhequr një kredi në Bankën për qëllime të biznesit në shumën prej 2,000,000.00 Euro (Dy milion euro) me destinim për të blerë shtëpitë e banimit në lagjen Marigona në vlerë prej 280,000.00 Euro, shlyerjen borxhit të kredisë së vjetër prej 250,000.00 Euro dhe pjesën tjetër e ka parashikuar për investimet në kompaninë simotër, Kompani 21 MDOOEL në Maqedoni të Veriut. Me rastin e kontrollit ATK-ë ka trajtuar këtë pjesë të kredisë ashtu që ka pranuar shpenzimet e kamatës (interesit) për pjesën e shfrytëzimit të kredisë, respektivisht për pjesën prej 250,000,00 Euro deri sa nuk i ka njohur si shpenzim kamatën e kredisë për pjesën tjetër, respektivisht për të blerë shtëpitë e banimit në lagjen Marigona dhe për investimet në kompaninë simotër, Kompani 21 MDOOEL në Maqedoni të Veriut, gjithnjë për periudhën kontestimore 2017-2018.

Gjykata pajtohet me konstatimin sikurse në ekspertizë të ekspertit financiar se shpenzimet e kamatës (interesit) për investimet në Kosovë, duhet të pranohen edhe në pjesën e kredisë së investuar për blerjen e shtëpive të banimit në Lagjen Marigona në vlerë prej 280,000.00 Euro, sepse të njëjtat janë pasuri e paluajtshme e kompanisë edhe me vet faktin se Departamenti i Ankesave i ka pranuar si mjete themelore.

Vlerësimet faktike dhe juridike lidhur me pikën III dhe IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoj të pa bazuara pretendimet e paditësit në padi, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me të gjeturat e ekspertit financiar si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata sa i përket mos njohjen e shpenzimeve të interesit për kredinë për investime në Maqedoninë e Veriut për periudhën kontestuese 2017-2018, pajtohet me të gjeturat sikurse në ekspertizën financiare, pasi që: pala paditëse nuk ka ofruar argumente të mjaftueshme as në procedure kontrolli e as në procedurë gjyqësore për çka është obliguar si tatimpagues të provoj të kundërtën everesimit të kontrollit se pjesa tjetër e kredisë është shfrytëzuar për qëllime biznesore në Kompaninë 21 M DOOEL në Maqedoni të Veriut. Në pasqyrat e konsoliduar të përpiluara nga paditësi por edhe në Raportin e Auditorit nuk figuron askund "Kompania 21 M DOOEL nga Maqedonia e Veriut të cilës i atribuohen Kredia dhe shpenzimet e interesit kontestues në këtë rast. Madje as ne Raportin e Auditorit respektivisht në Pasqyrat e Konsoliduara Financiare nuk është e theksuar askund linja apo pozicionet e Kompani 21 M DOOEL me kompaninë mëmë Company 21 SH.P.K në Prishtinë. Në shkresat e lëndës nuk kemi hasur Pasqyrat Financiare te Kompani 21 M DOOEL nga Maqedonia e Veriut për periudhën 2017 dhe 2018. Prandaj bazuar edhe në të gjeturat sikurse në ekspertizë financiare të datës 25.03.2024, dhe dispozitës së Ligjit 03/L-222 neni 19 pika 6 citojmë " tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë, nuk mund të konstatohet se shpenzimet e kamatës (interesi) nga investimi në Kompaninë 21 M DOOEL në Maqedoni të Veriut, janë të atribueshme në pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018 të kompanisë Company 21 SHPK ne Kosovë.

Gjykata vlerëson si të drejtë edhe mos njohjen e zhvlerësimit respektivisht të investimeve në sallën 1 Tetori – Prishtinë, për periudhën kontestuese 2017-2018, kjo ngase periudha e shfrytëzimit të sallës 1 Tetori është bërë në bazë të kontratës në mes paditësit Company 21 SH.P.K dhe Sallës 1 Tetori dhe për periudhën prej 14.03.2013 deri me 31.05.2017 dhe për të njëjtën ka pas investime kryesisht në periudhën e vitit 2013 bazë e cila mund të bartet si shpenzim zhvlerësimi për vitet vijuese deri në vitin 2017, këto investime janë deklaruar në ATK dhe janë të pranueshme si fakt nga ATK. Pjesa e zhvlerësimit e cila ka qenë kontestuese në shumën bazë të zhvlerësimit prej 6,139,60 Euro është deklaruar sipas legjislacionit në fuqi Ligji mbi Tatimin në të ardhurave të Korporatës 03/L-029 neni 15 pika 2 citojmë 2. "Shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike te tatimpaguesit do të kompensohen përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë " përderisa për periudhën kontestuese 2017 kontrata për shfrytëzimin e Sallës së Sporteve është shkëputur dhe se ATK ka vlerësuar drejtë dhe sipas legjislacionit ne fuqi"

Si rezultat, Gjykata konsideron se paditësi në këtë kontest tregtar administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi lidhur me mos njohjen e shpenzimeve të interesit për kredinë për investime në Maqedoninë e Veriut, dhe mos njohjen e zhvlerësimit respektivisht të investimeve në sallën 1 Tetori – Prishtinë për periudhën kontestuese 2017-2018, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar në pjesën e vërtetuar nga gjykata është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se vendimi nr. 577/2019 datë 12.03.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, në këtë pjesë është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, andaj edhe ka vendosur sikurse në pikën III dhe IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vlerësimet tjera në pjesën jo kontestuese, mbesin në fuqi sipas vendimit nr.577/2019 datë 12.03.2020 i Divizionit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.351/24 datë 14.05.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.